



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË  
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 03, datë 22.01.2021

PËR  
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË  
MASTER PROFESIONAL NË “DREJTIM I SME-VE”, TË UNIVERSITETIT  
“ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “**Drejtimit i SME-ve**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Profesional në “**Drejtimit i SME-ve**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1161, datë 25.11.2009 , miratuar riorganizimi me shkresë të MASR Nr. 7243/1, datë 22.08.2018.
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Menaxhimit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 1 vit / 2 semestra
- g) Kredite (ECTS): 60 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

**pasi mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

**konstaton se:**

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
  1. Ngarkesa mësimore nuk mbulohet në masën të paktën 70 % nga stafi akademik efektiv me tituj dhe grada, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
  2. Mungesa e lëndëve karakterizuese në këtë program studimi.
  3. Syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  4. Mungon një studim i mirëfilltë i tregut të punës ku të analizohen dhe reflektohen nevojat reale të këtij programi studimi, në tregun e punës.
  5. Mungon një plan-buxhet i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond i veçantë për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.
  6. Mungon përfshirja e stafit të pavarur dhe përfaqësuesit të studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të brendshëm të cilësisë.
  7. Nuk ka një analizë të të dhënave të punësimit të studentëve pas diplomimit, në këtë program studimi.
  8. Mungesa e sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit për këtë program studimi.

9. Mungon Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së institucionit sikurse parashikohet në Statutin e UAMD-së në Kreun VII të tij.
10. Detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë apo person përgjegjës nuk janë të përcaktuara dhe në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.
11. Logjistika IT dhe programet kompjuterike, e varfër dhe me mungesa.





*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,*

#### VENDOSI:


1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Master Profesional në “Drejtëm i SME-ve”**, të **Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës**, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **2 (dy)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **30/09/2023**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### BORDI I AKREDITIMIT


ARJAN GJONÇA		Kryetar
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
FABRICE HENARD		Anëtar
ARBEN MERKOCI		Anëtar

ALEKSANDËR XHUVANI



Anëtar

ANILA PAPARISTO




Anëtar

SULO HADERI


Anëtar

LULJETA MINXHOZI




Anëtar

GËZIM VISOKA




Anëtar

DRINI IMAMI



Anëtar

FATMIR GURI



Anëtar

*Z. S.Haderi nuk morri pjesë në këtë mbledhje*

## Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 03, datë 22.01.2021, “Për akreditimin e parë të programit të studimit **Master Profesional në “Drejtimit i SME-ve”**”, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, janë si vijon:

1. Institucioni, të rekrutojë personel të ri akademik, me tituj dhe grada, për të mundësuar mbulimin e ngarkesës mësimore në masën mbi 70% nga personeli akademik efektiv (PAE) në përmbushje të detyrimeve ligjore.
2. Institucioni, të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit lëndë karakterizuese për ti mundësuar studentëve të thellohen, specifikisht në problemet e menaxhimit të SME-ve si dhe për ti ofruar atyre shprehi të veçanta në fushën e drejtimit të SME-ve në përputhje edhe me nevojat e tregut të punës.
3. Institucioni, të rishikojë dhe përditësojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
4. Institucioni, të hartojë një plan-buxhet të detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond të veçante për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line.
5. Institucioni, të përfshijë staf të pavarur ose ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve në kryerjen e funksioneve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.
6. Institucioni, të realizojë një analizë të të dhënave të punësimit të studentëve të këtij programi studimi pas diplomimit të tyre.
7. Institucioni, të implementojë sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit edhe për stafin dhe studentët e këtij programi studimi duke siguruar akses në informacione dhe dokumenta, si për stafin e UAMD-së edhe për studentët e këtij programi studimi.
8. Institucioni, të zbatojë parashikimet që i ngarkon Statuti i UAMD-së në Kreun VII të tij si edhe kuadri rregullator në fuqi për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së institucionit.
9. Institucioni, të përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë për çdo strukturë apo person përgjegjës, në përputhje me kriteret, kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.
10. Institucioni, të marrë masa për pasurimin dhe plotësimin e logjistikës IT dhe programeve kompjuterike.
11. Institucioni, të kryejë vlerësimin e njohurive dhe dijeve me shkrim, në mënyrë anonime.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

